

NDIHMJA EKONOMIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

<u>Emri i Shërbimit</u>	Kërkesë për përfitimin e ndihmës ekonomike nga person me aftësi të kufizuar
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	<u>“Ndihmë ekonomike për person me aftësi të kufizuar”</u> nënkupton mbështetjen financiare të individëve me status të veçantë. <u>“Person me Aftësi të Kufizuar (PAK)”</u> kuptohet individi, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko / mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin. Në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara bëjnë pjesë dhe “Invalidët e punës”, të cilët e marrin këtë status me vendim të KMCA (Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë), nëse janë aksidentuar në punë ose janë të sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme. Paratetraplegjikët që kanë fituar statusin me vendim të K.M.C.A.P përfitojnë dhe një pagesë shtesë për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjienosanitare.
<u>Baza ligjore:</u>	▪ Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ▪ Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 Kodi i Procedurave Administrative ▪ Ligji nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbimet shoqërore” ▪ Ligj nr. 47/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar ▪ Udhëzim nr.6, datë 7.8.2013 Mbi zbatimin e vendimit nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar ▪ Vendim nr.277 datë 18.6.1997 Për përfitimet nga statusi i të verbëritë ▪ Udhëzim nr.7, datë 7.8.2013 Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", të ndryshuar ▪ Udhëzim nr.5, datë 7.8.2013 Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të këshillit të ministrave "për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar
<u>Përfituesi</u>	Qytetarët,
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	DKS – Drejtoria e Kujdesit Social, Sektori i Pagesave Kesh
<u>Afati</u>	30 ditë
<u>Tarifa</u>	Nuk ka tarifë
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	Dokumentacioni bazë: ✓ Vërtetim nga sigurimet shoqërore; ✓ Vendimin e KMCA; ✓ Kopje të dokumentit të identifikimit; ✓ Numrin e llogarisë bankare. ✓ Dokumentacioni për përfitimin e P.A.K (Aplikim për here të parë) ✓ Certifikatë e gjendjes familjare; ✓ Certifikatë personale;

	✓ Dokument identifikimi (mbi 18-vjet); ✓ Fletë drejtimi për në K.M.C.A.P. + (dokumentacioni shtesë për llojin e sëmundjes); ✓ Epikrizën përçjellëse sa herë komisionet. ✓ Dokumentet shtesë për përfitimin e P.A.K (GRUPI I PARË) ✓ Certifikatën e personit kujdestar; ✓ Dokument identifikimi; ✓ Deklaratë/vendim gjyqësor për kujdestarin e zgjedhur dhe raport mjek ligjor që vërteton që kujdestari është i aftë fizikisht e mendërisht. Për P.A.K. që ndjekin shkollën e mesme apo të lartë me apo pa shkëputje nga shkolla duhet të paraqesin dhe dokumentet shtesë: ✓ Vërtetim nga titullari i shkollës apo sekretari me të dhënat e mëposhtme: ▪ Emri i personit ▪ Lloji i arsimit ▪ Viti shkollor <i>Ky vërtetim duhet paraqitur çdo 3 muaj.</i> ✓ Kopje e noterizuara e dëftesës, çdo vit të diplomës. ✓ Vërtetim që ka shlyer detyrimet për çdo sezon, për shkollën e lartë me shkëputje nga puna. Personat e verbër, të cilët ndjekin shkollën duhet të paraqesin: ✓ Vërtetim nga titullari ose sekretari i shkollës që përmban: ▪ Emrin ▪ Llojin e arsimit ▪ Vitin shkollor, ▪ Nëse është cikël normal, me korrespondencë apo përsëritës. ✓ Vërtetim të firmosur nga titullari për frekuentimin e shkollës çdo 3-mujor ✓ Për të verbrit që frekuentojnë shkollën me korrespondencë dhe vërtetimin që kanë shlyer detyrimet. ✓ Personat e verbër, të cilët pajisen për herë të parë me librezë duhet të paraqesin: (edhe) ▪ Certifikatë personale ▪ Dokument identifikimi ▪ Fotografi
--	--